



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Oraovac/Municipal Assembly Rahovec

PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.03.2018** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes, **Kryesuesi Dina** – Fillimisht më lejoni të përshëndes Kryetarin e Komunës z. Smajl Latifi, Nënkryetarin e Komunës z. Fatmir Iska, përfaqësuesit e LMT-së, monitoruesit e OSBE-së, përfaqësuesit e mediave, drejtorët e drejtorive komunale, delegatët e kuvendit komunal dhe gjithë të pranishmit. Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve,
3. Rishqyrtimi i vendimit 01 Nr. 592, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2017-2018,
5. Shqyrtimi i Raportit Financiar të vitit 2017,
6. Informatë Financiare mbi obligimet kontraktuale dhe financiare 2012-2017,
7. Shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për shëndetësi,
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit,
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit 01 Nr. 585, rreth ndërtimit të palestrës sportive në Krushë të Madhe,
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozimit të Kryetarit 01 Nr. 124/2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronës së Paluajtshme komunale për “Ndërtimin e Palestrës Sportive”, në fshatin Krushë e Madhe.
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për iniciimin e procedurave për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe,
12. Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit dhe marrja e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare.

Kryesuesi – E qes në aprovim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës.

Të nderuar ne sot kemi menduar që do të transmetohet online mbledhja e Kuvendit Komunal, por sipas zyrtarit të IT nuk është e mundur një herë por shpresojmë se shumë shpejtë do të bëhet. Po ashtu a ka dikush të arsyetoj mungesën në mbledhjen e kaluar, nëse po urdhëroni.

Besnik Hoti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, arsyetimi imë për mungesë në mbledhjen e kaluar është ju siç e dini unë e mbaj edhe pozitën e zv. Ministrit të Punëve të Jashtme, arsyeja pse kam munguar është kam qen i ftuar nga Kongresi Amerikan dhe kam marrë pjesë atje.

Astrit Thaqi - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, arsyeja pse kam munguar në Mbledhjen e kaluar është sepse kam udhëtuar jashtë shtetit për disa punë personale.

Vahid Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, arsyeja pse kam munguar në Mbledhjen e kaluar ka qenë për shkak të angazhimit në disa punë personale.

Kryesuesi – Para se të ja fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës desha që të ju informoj se na është kthyer një shkresë nga MAPL-ja për vendimet e mbledhjes së Kaluar, konfirmimi si i paligjshëm në është kthyer rreth formimit të KPF-së arsyeja është sepse nuk ju kemi përmbajtur kuotës gjinore. Po ashtu desha që të ju japë edhe një informatë pasi që të përfundoj mbledhja ju kisha lutë që të shkoni tek zyrtari i IT që të bëni nga një foto në mënyrë që të ju vendosë në veb faqen e Komunës. Gjithashtu keni një shkresë për formimin e grupit jo formal të grave, kishte me qenë mirë që në kohën e pauzës ju gjinia femërore të mbani një takim ku do të diskutoni rreth formimit të këtij grupi. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush të shtoj ose ndonjë vërejtje sa i përket Procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e qenë në aprovim Procesverbalin: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e radhës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.

Të nderuar Kuvendarë disa drejtorë ju janë përgjigjur pyetjeve nga mbledhja e kaluar me shkrim përmes emailit. A ka dikush të bëjë ndonjë pyetje ekzekutivit të Komunës.

Besmire Bytyqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, dua të flas për një çështje e cila më brengos mua ajo është ndarja e subvencioneve nga Drejtoria e Rinis Kulturës dhe Sportit, duke e marrë parasysh debatet në kohën e zgjedhjeve Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi ka premtuar se do të përkrah organizatat rinore specifiku Qendrën Rinore SHL-Kosova, por besoj se me 500.00 € që i ka ndarë tani Komuna e Rahovecit kësaj qendre me gjitha ato projekte që ka aplikuar kjo qendër është sa për të thënë që i kemi ndihmuar diçka. Pyetja ime konkrete për Drejtorin e Kulturës Rinisë dhe Sporteve është se a do të vazhdojë kështu ta injoroi një organizatë siç është SHK- Kosova e cila e bënë një punë jashtëzakonisht të mirë për rinin e Rahovecit apo do të ndryshojë diçka.

Vahid Krasniqi – Javën e kaluar në një bisedë jo formale kam biseduar edhe me Kryetarin sa i përket çështjes së ndarjes së subvencioneve që është bërë nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Mendimi imë është se këto ndarje janë bërë në mënyrë të njëanshme dhe jashtë rregullores për ndarjen e subvencioneve Komunale sepse në rregullore në nenin 4 ceket: Kryetari i Komunës merre vendim për ndarje deri në 1,000.00 € për personat fizik, kurse për personat juridik deri në 2,000.00 €, kurse nëse kalohet shuma 2,000.00 € atëherë vendos Kuvendi i Komunës. Kjo praktik është praktikuar në të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës. Mendoj se në komunën tonë është bërë një e padrejtë ndaj Klubit KF Derenoci dhe KF Dejti, asnjë rregullore nuk e ndanë çmimin kur janë në ligën e njëjtë KF Drenoci, KF Dejti dhe KF Xërxa janë në ligën e dytë dhe në këtë rast KF Drenoci dhe KF Dejti janë anashkaluar, kjo pyetje shkon për Kryetarin. Po ashtu kam edhe një pyetje për Drejtorin e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, e kam përcjellë në një radio ku ka qenë i ftuar, ku patë premtuar se në dallim nga Drejtori i Kaluar unë do të thellojë raportet me qendrat rinore në 3 mujin e parë, pyetja ime për të është çka ka bërë në 3 mujin e parë me Qendrat Rinore. Po ashtu patë thënë se do të sigurojë donacionet e jashtme në 3 mujin e parë për ndërtimin e qendrave sportive edhe për këtë dua ta di se çka ka bërë në këtë 3 mujin e parë.

Rexhep Oruqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha vetëm ta ri' përsërisë pyetjen e mbledhjes së Kaluar që ka të bëjë rreth pagesës së mëditjeve që na kanë mbetur pa paguar, pasi qenka drejtori prezent besoj se do na jepe ndonjë përgjigje, pasi deri më tani askush nuk kemi marrë përgjigje. Pyetja e dytë është çështja e Statusit juridik të stacionit të autobusëve në Komunën e Rahovecit, kjo çështje është ngritur edhe disa vite më herët ku Kuvendi ka marrë një iniciativë që të bëhet shoqëri aksionare dhe i vetmi aksionar sipas ligjit duhet të jetë Komuna e Rahovecit. Këtë po e ngrisë për së dyti herë sepse çështja e këtij stacioni ka mbetur në fatin e askujt, atë e menaxhon një drejtor i vetëshpallur i cili veç se ka dalë në pension, kurse stacioni është një aset shumë me rëndësi i Komunës. Iniciativa e kaluar ka dështuar për shkak të mungesës së profesionalizmit sepse u

patë formuar një grupe formues por qysh në fillim nisën që ti caktojnë aksionarët dhe kërkesa e tyre qysh në fillim ka qenë që Komuna të i pagojë ata pa ja filluar fare ata punës, prandaj është mirë që organet e Komunës ta marrin si iniciativë dhe ta kthejnë këtë pronë Komunës.

Hanalora Hoti – Përshëndetje për të gjithë – Pyetje ime shkon për Drejtorin e Shërbimeve Publike, të nderuar rruga për në fshatin Baboc konkretisht tek lagja e Haxhi Shalës një person i ka vendosur 3 gypa të kanalizimit me format shumë të ngushtë, këta gypa në raste kur ka reshje të mëdha nuk funksionojnë sepse nuk kanë kapacitet, e keqja e gjithë kësaj është se fëmijëve të kësaj lagje ju pamundësohet kalimi i rrugës për të shkuar në shkollë. I nderuar Drejtor në raste se nuk mirët ndonjë masë së shpejti atëherë do të kemi dëmtim të kësaj ruge e cila është e shtruar me asfalte, ky është shqetësimi i cili vije nga kjo lagje presim iniciativën nga drejtoria përkatëse.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit – Një prej çështjeve mjaftë aktuale për banorët e fshatit Ratkoc me rrethinë është vendosja e rrjetit të kanalizimit, po të tjerash kjo temë është bartur nga mandati në mandat në vazhdimësi, po ju kisha lutur juve si Kryetar që ti keni parasysh këto dukuri sepse sa herë që ka reshje të dendura shiu banorët Ratkocit veçanërisht familjet Hoti, Morina, Shala etj. Përballen me problematikën e njëjtë. Çështje tjetër që unë dua ta ngris është edhe arsimi fushë së cilës edhe i takoj, i nderuari Kryetar duhet që të keni parasysh vlerësimet nga PISA po ashtu këtu do të ndërlihdesh edhe me Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit edhe pse gjithmonë marrim informacione dhe lëvdata si nga mësimdhënësit po ashtu edhe nga personat zyrtar të arsimit por janë vlerësimet si nga PISA po ashtu edhe nga testi i maturës ato të cilat na argumentojnë suksesin. Mendoj se motivi i nxënësit dhe një studentit arrihet vetëm atëherë kur nuk i neglizhojmë problematikën përkatëse duke i lënë anash si në bursa dhe në organizimet e ndryshme brenda të cilëve duhet që të ndihen të barabartë vetëm e vetëm nëse e meritojnë e jo nëse i takojnë interesave përkatëse politike, kërkoj nga ana e juaj që të më tregoni se sa i keni menduar këto dukuri si testin PISA dhe testin e Maturës, po ashtu edhe bursat dhe problematikën të cilat i shqetësojnë më tepër se çdo të rinjtë dhe studentët e Komunës së Rahovecit.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po ju barti një shqetësim të ngritur nga banorët e fshatit Ratkoc, në kohë fushate në këtë vendbanim janë ndërtuar disa rrugë me kubëza, pusetat të cilat kanë qenë të vendosura përmes rrugës janë mbuluar me kubëza pra nuk janë vendosur kapakët e pusetave, sa e di unë rregullat e ndërtimit nuk e lejojnë një gjë të tillë. Banorët e këtij lokaliteti i kanë hequr kubëzat me iniciativën e vetë dhe tani pusetat kanë mbetur të hapura. Pyetja ime për Drejtorin e Shërbimeve Publike është: Si ka qenë marrëveshja me punë kryesin e kësaj ruge a ka qenë marrëveshja që të mbulohen me kapak apo si.

Vjosa Isma – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Pyetja ime është për Drejtorin e DKA-së, i nderuari drejtori fillimisht ju falënderoj për përgjigjen tuaj në pyetjen time drejtuar juve ditë më parë, me qëllim të qartësimi dhe adresimit të shqetësimeve të shumta të qytetarëve përkatësisht kolegëve të mi mësimdhënëse unë kam edhe një pyetje shtesë e cila ndërlihdet me pyetjen e mëparshme që u kam adresuar. I nderuari Drejtor cila ka qenë arsyeja e lëvizjes së mësimdhënëseve nga një shkollë në tjetrën, pasi ka pas zvogëlim të normës dhe orëve ndërsa mësimdhënësi ka pasur kontratë për normë të plotë deri diku do të ishte normal që ti jepet orë shtesë në vendin tjetër të punës, por çdo lëvizje tjetër që bëhet është në kundërshtim me ligjin, pasi që sipas ligjit të punës nenit 4 paragrafit 6 të udhëzimit administrativ MPMS 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik i cili precizon përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, organi përkatës i autorizuar me aktin e brendshëm duhet fillimisht të shpallë konkurs të brendshëm nëse ka më shumë se një kandidat të cilat i plotësojnë kushtet e kërkuara për plotësimin e vendit të lirë të punës. Në rastin në fjalë mos shpallja e konkursit të brendshëm është shkelje, rrjedhimisht diskriminuese pasi që nuk ju është dhënë mundësi të tjerëve që të konkurrojnë nëse kishin interes për të njëjtën pozitë.

Florije Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, më vije mirë që janë duke u ngritur shumë çështje, por besoj se një qeveri brenda 2 muajve nëse i zgjidhë të gjitha problemet nuk e di se çka do të punojnë kolegët e tjerë. Këto janë shqetësimet e qytetarëve dhe duhet që të ngritën por kjo është në kohë shumë e shkurtër që ti kryej qeverisja aktuale të gjitha punët. Po ashtu edhe unë si kolegët e mi kam një shqetësim sa i përket ndërtimit të çerdhes në qytetin e Rahovecit, gjatë fushatës partitë që kanë qenë në pushtet patën deklaruar se ne do

ta përfundojmë çerdhen, prandaj kërkoj nga Drejtoria e Arsimit që në mbledhjen e ardhshme të na njoftoj se ku ka mbete puna e kësaj çerdhe, ky është shqetësim edhe i nënave të qytetit të Rahovecit.

Faton Ramadani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje për Drejtorin e Bujqësisë sa i përket projektit të drenazhimit të tokave bujqësore i cili ka filluar që të implementohet para 3-4 viteve. Kërkoj nga Drejtori i Bujqësisë që të na jepe një informatë rreth këtij projekti, a është përfunduar i tëri apo jo dhe nëse jo pse ku ka ngecur puna.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, përveç Drejtorit të Financave që do të ishte mirë që sot ti i jepe përgjigje çështjes së mëditjeve, kurse Drejtorët e tjerë që kanë pasur pyetje do të ju përgjigjen të gjitha shqetësimeve me shkrim ose me gojë në mbledhjen e ardhshme. Unë dola sot këtu që ti japë përgjigje disa çështjeve parimore të cilat u ngritën këtu. Çështja e inicimit të stacionit të autobusëve është bërë temë në qeverinë e kaluar dhe në qeverinë aktuale, besoj se në këtë çështje do të angazhohemi në të ardhmen e afërt dhe do të përpiqemi që ti definojmë sepse ky aset jashtëzakonisht i rëndësishëm me të vërtetë ka mbetur pezull dhe duhet që të trajtohet me kujdes nga Komuna e Rahovecit, po ashtu duhet që të futet në menaxhim të Komunës në bashkëpunim me partnerët aksionarë dhe po ashtu në pajtim me ligjin duhet që të funksionoj sepse gjendja e këtij stacioni është me të vërtetë keq. Ne kemi ndërmarr dhjetëra veprime të cilat kryesisht kanë të bëjmë me emergjenca që lidhën me përmbytjet e tokave bujqësore, me vërshime ku janë dëmtuar edhe shtëpitë e qytetarëve tanë, ne kemi formuar një komision i cili e ka bërë një incizim të gjendjes, ka bërë një vlerësim të dëmeve të shkaktuara qoftë nga tokat bujqësore nga përmbytjet qoftë edhe të pronave private. Ky komision sipas rregullit do ti adresohet edhe Kuvendit të Komunës por edhe Ministrisë së Bujqësisë që të na jepet ndihmë për kompensimin e dëmeve ose përkrahje për ata që janë dëmtuar nga reshjet e fundit. Ju kujtohen disa aktivitete që janë zhvilluar me qendrën SHL-Kosova, kjo qendër një mbështetje simbolike ka mare nga Komuna por mos të harrojmë se viti është i gjatë dhe ne e dimë që kërkesat e SHL- Kosovës natyrisht janë legjitime dhe ne do të përpiqemi që ti adresojmë sepse ne e dimë që ata i kanë edhe disa shpenzime të cilat nuk munden që ti përballojnë vet, dy ose tre aktivitete i kemi zhvilluar së bashku në koordinim qoftë me DKA-në ose DKRS-në, personalisht kam qen në takim tek ata por edhe ata kanë qen 2-3 herë në takim tek ne ku na kanë sjellë disa kërkesa ku do të përpiqemi që ti japim përgjigje pozitive. Ne e dimë se 500.00 € janë pak por janë parat e taksapaguesve të Komunës sonë, kurse në vitet e kaluara kjo qendër nuk ka përfituar asnjë mbështetje financiare nga Komuna. Për sa i përket çështjeve të shqetësimeve që ndërlidhem me Drejtorin e Shërbimeve Publike, natyrisht ne kemi plotë shqetësime dhe vërejtje por ne jemi vetëm në 3 mujorin e parë dhe fatkeqësisht është dashur që të bëjmë shumë ndërhyrje emergjente në shumë vendbanime për shkak të situatave të krijuara, por për të gjitha çështjet do të merrni përgjigje me shkrim nga Drejtorët përkatës. Për sa i përket subvencioneve të DKRS-së është një rregullore e cila i përcakton kriteret por për ma shumë i përgjigjemi me shkrim edhe kësaj pyetje. Por mos të harrojmë se kanë dalë përtej mbështetjes aktuale që kanë marrë klubet sepse ata po kanë nevojë për mbështetje si në transporte për të shkuar në qytetet e ndryshme për të luajtur dhe është mirë që ti pyetni ata se kush është duke i paguar shpenzimet e udhëtimit klubi apo Komuna. Sa i takon drenazhimit të tokave bujqësore ju siguroj se qoftë në Celinë, Xërxë, Fortesë, por edhe kanali i kullimit të tokave bujqësore në Ratkoc, jam duke dhënë vetëm përgjigje parimore do të trajtohen me prioritet të lartë sepse ne e dimë saktë sepse ka dy muaj që ballafaqohemi me projektet e papërfunduara e që duhet të përfundojnë, por besojmë se do të marrim masa në këtë vit për këto probleme që janë bukur serioze. Ju siguroj si Kryetar i Komunës se të gjitha shqetësimet të cilat i ngrisin kuvendarët e Kuvendit do të përpiqemi që ti japim përgjigje të qartë sepse e kemi obligim ligjor dhe transparencë në këtë rastë është prioritet i lartë i qeverisë të cilën unë e drejtoj, absolutisht mos u kurseni bëni pyetje edhe me gojë edhe me shkrim, ngritëni shqetësimet e juaja sepse kjo është detyra jonë e përbashkët.

Vjosa Isma – I nderuari Kryetar unë një pyetje e kam adresuar Drejtorit DKA-së dhe zyrës së Kryetarit përmes emailit por përgjigje nuk kam ë marrë, pyetja ka qen : Cilat kanë qen kriteret për përfitim të bursës studentore, sepse ka pas shumë ankesa nga ana e studenteve të cilët nuk kanë përfituar bursa, pastaj pyetje tjetër ka qen kush ishin anëtarët e Komisionit për vlerësimin e ndarjen e bursave dhe kush janë përfitues të bursave, ku kam kërkuar listën e përfituesve.

Kryetari – E nderuara znj. Vjosa Isma përgjigjen por ta japë tani, urdhëroni hynë në veb faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit, aty do ta shihni listën e përfituesve të bursës. Sa për informacion parimor ka qen një komision me vendim i cili ka bërë vlerësimin në bazë të kriterëve të cilat i përcakton rregullorja, informacion të shkruar nuk besoj se ka nevojë të ketë por urdhëroni dhe shihni i raportin final të cilin ne e japim, po ashtu sa për dijeninë tuaj këta studentë kanë aplikuar që 6 - 7 muaj, më parë nuk është bërë asnjë veprim tjetër ne duhet që të jemi të kënaqur që kmeri mbërri qysh në këtë fazë ti adresojmë këto çështje dhe ti japim përgjigje, gjëja ma e mirë është se një numër i madhe i studenteve kanë përfituar nga taksat komunale të Komunës së Rahovecit në përkrahje për studimet e tyre. E nderuara znj. Vjosa përgjigje më tjetër nuk e di ku mundesh me marrë, ju mundeni që të i drejtoheni edhe Komisionit për ndarjen e bursave ai është më kompetent për të ju përgjigjur kësaj pyetjes të cilën e parashtruat.

Vahid Krasniqi – Në një farë formë ju i nderuari Kryetar e dhatë një përgjigje sa i përket ndarjes së subvencioneve. Nga klubi është bërë një ankesë në afatin ligjor, por ajo ankesë nuk është protokolluar në afatin ligjor, dua ta di arsyen pse nuk është protokolluar kjo kërkesë, sa e di unë edhe Drejtori i Ekonomisë që është bashkëfshatari imë është edhe anëtar i Klubit.

Kryetari - Këto janë çështje teknike të cilat duhet që të merrni përgjigje nga Drejtoria e Administratës, por sidoqoftë jam shumë i kënaqur që kam arritur të nënshkruaj me dy klube dy kontrata në fshatin Drenoc, do të jem shumë i kënaqur nëse i ndihmojë edhe më shumë klubit KF Drenoci dhe asaj shkolle të futbollit.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kur jemi në pikën e dytë të rendit të ditës desha të ngrisë një çështje sa i përket fushës së shëndetësisë, por mendoj se kjo çështje kishte me qen më mirë që të diskutojmë në mbledhjen e ardhshme që ka të bëjë me Sistemin e Informimit Shëndetësorë, Forma Digjitale Elektronike, kjo çështje për mendimin time është shumë me rëndësi, ne si QKMF vitin e kaluar kemi filluar që të punojmë me këtë sistem, por ka 5 muaj që ky sistem nuk funksionon, prej sa ka filluar që të ndërtohet objekti i ri i QKMF-së në oborr ne nuk jemi duke punuar me këtë sistem. Mendoj se Komuna jonë është në humbje për shumë arsyeje, duke i përfshi të hyrat nga ky projekt, kisha kërkuar nga Drejtori Komunal i Shëndetësisë që për mbledhjen e ardhshme që të kemi një pikë të rendit të ditës sa i përket kësaj çështje, kishte me qen mirë që drejtori ta përgatis një informatë të hollësishme në lidhje me këtë sistem në mënyrë që sa më shpejtë të futet në përdorim.

3. Rishqyrtimi i vendimit 01 Nr. 592, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi – Siç ju thash në fillim ne duhet që ta plotësojmë këtë Komitet edhe me një grua, pra grupi i PDK-së duhet që të bëjë një zëvendësim të heq një anëtar të gjinisë mashkullore dhe ta zëvendësoj me një anëtare të gjinisë femërore.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket kësaj çështje ne si grupe i PDK-së jemi dakorduar që Florida Bajraktari e cila është përzgjedhur anëtare e Komitetit për Komunitete ta tërheqim nga ky komunitet dhe ta propozojmë për anëtare të KPF-së, kurse për anëtare të Komitetit për Komunitete e propozojmë znj. Afërdita Thaqi.

Florije Boshnjaku – Tani i kemi të ngritura dy çështje këtu, së pari duhet që të bëhet plotësim ndryshimi i vendimit të Komitetit për Komunitete, e qesim në votim pastaj bëhet prapë plotësim ndryshimi i KPF-së dhe e qesim në votim, pra dy herë duhet që të shkohet në votim.

Kryesuesi - E qes në votim Plotësim ndryshimin e vendimit të Komitetit për Komunitete ku si anëtare e saj u propozua znj. Afërdita Thaqi: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar propozimi i grupit të PDK-së që si anëtare e re e Komitetit për Komunitete të jetë znj. Afërdita Thaqi. E qes tani në votim propozimin për Plotësim ndryshimin e vendimit të KPF-së që si anëtare të jetë znj. Florida Bajraktari: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar propozimi i grupit të PDK-së që si pjesë e KPF-së të jetë znj. Florida Bajraktari. Pra znj. Florida Bajraktari e ka zëvendësuar në KPF- z. Rexhep Oruqin, kurse znj. Afërdita Thaqi e ka zëvendësuar në Komitet për Komunitete znj. Florida Bajraktari, kjo ka ndodhur për shkak të përmbushjes së kuotës gjinore e cila na është kërkuar nga MAPL-ja. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2017-2018.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, ligji mbi buxhetin e vitit 2018 konkretisht ligji 06/L-20 neni 9 e përcakton qartë bartjen e të hyrave vetanake për çdo organizatë buxhetore nga viti 2017 – 2018. Për Komunën tonë bartja e të hyrave në total është 174,212.05 €, bartja e të hyrave është bërë nga kodi 21 dhe këto të hyra kreishtë barten nga një periudhë në tjetrën. Në bazë të analizës së buxhetit dhe duke pas parasysh borxhet që i kemi ne kemi menduar që ti bëjmë një orientim të drejtë këtyre mjeteve, kryesisht jemi fokusuar në 3 drejtime ku i kemi trajtuar borxhet më të mëdha, pastaj i kemi trajtuar edhe investimet kapitale, të cilat janë në linjën buxhetore të vitit 2018, për shkak të mjeteve të vogla e kemi bërë një bartje edhe pse është shumë simbolike, njëkohësisht i kemi futur edhe 3 projekte të reja të cilat kanë ardhur nga drejtoritë përkatëse p.sh projekti Ndërtimi i Kanalizimit në Komunën e Rahovecit, ky projekt ka ardhur në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Shërbimeve Publike, pastaj si projekt i ri tjetër është rregullimi dhe rrethimi i fushës së sportit në fshatin Ratkoc, të nderuar Kuvendarë në këtë fshat është një fushë shumë e mirë e cila nuk ka kohë të gjatë që është ndërtuar por unë personalisht e kam parë ajo fushë gati ishte tjetërsuar, që mos të lëmë të shkatërrohet në tërësi Drejtoria e Kulturës ka paraparë që të ndajë një shumë simbolike prej 4,000.00 € për këtë fushë, personalisht në këtë fushë kam parë edhe kamionë me pesha të rënda që kanë qenë të parkuara aty. Si projekt tjetër i ri është edhe riparimi i shtëpisë së Kulturës në fshatin Ratkoc, po ashtu edhe ky projekt ka ardhur nga Drejtoria e Kulturës si nevojë sepse në kuadër të këtij objekti është shkatërruar çatia dhe vazhdimisht kur ka të reshura atmosferike ka rrjedha të mëdha të ujit të cilat i kanë shkatërruar edhe muret. Pra bartje e të hyrave në total është 174,212.05 €, për investime kapitale janë 171,999.00 €, kurse për mallra dhe shërbime janë 29.35 €. Të nderuar Kuvendarë pres nga ju që ta përkrahni këtë pikë të rendit të ditës.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje sa i përket bartjes së mjeteve, bartja e mjeteve për projektin rregullimi i varrezave në fshatin Pastasel i cili projekt ka qenë nga qeverisja e kaluar, pyetja ime është a është bërë pranimi teknik i këtij projekti sepse ka shumë ankesa nga banorët se aty është kryer vetëm faza e parë e punimeve, pra kompani e cila e ka fituar këtë projekt nuk i ka kryer punët fare si duhet, nëse e ka pranuar këto punimet komisioni, cili është ai komision sepse këtu është duke u parë si projekt i përfunduar. Po ashtu dua ta di se ky financim a është vetëm nga Komuna apo është bashkëfinancim nga Komuna dhe Qeveria.

Afrim Limani – E nderuara znj. Mirjeta Krasniqi qysh në fillim e thash se ne i kemi dhënë prioritet disa pagesave dhe disa borxheve përkundër asaj që është shuma simbolike, ne e kemi trajtuar edhe projektin e rregullimit të varrezave në fshatin Pastasel ku e kemi ndarë një shumë prej 10,420.00 €, këtu e kemi një sqarim për të ju hequr dilemat e juaja pagesat janë bërë qsa sa janë raportuar borxhet, borxhet për këtë projekt na kanë ardhur në kuadër të kësaj vlere. Për detaje tjera të këtij projekti unë nuk mundem me të dhënë përgjigje sepse ndoshta nuk jam kompetent por sigurisht se në seancën e radhës këtë përgjigje do ju japë Drejtori i Shërbimeve Publike, sa kam unë informata ky projekt është i financuar edhe nga granditë qeveritar dhe një pjesë nga të hyrat vetanake të Komunës. E nderuar përderisa është raportuar borxhi kjo i bije që pranimi teknik i këtij projekti është bërë për këtë situacionë, ndoshta ka edhe situacionet e tjera të cilat janë në proces.

Rasim Fazliu – Në mënyrës shoqërore desha të them që së pari është më mirë që Kuvendarët ti i shtjerrin diskutimet, Drejtorët le të mbajnë shënime dhe pastaj mundë të dalin që ti japin përgjigjet e tyre. Personalisht mendoj se bartja e të hyrave duhet që të ndodhë ne nuk jemi kundra kësaj pune, por meqenëse ka borxhe e pse nuk është shkuar një herë me shlyerje të borxheve e pastaj të hyhet me projekte të reja edhe pse janë simbolike vetëm diku 18,000.00 €.

Kryetari – Jemi duke u përpjekur i nderuari z. Rasim Fazliu, ne jemi në situatë ku e kemi një listë e cila kanoset nga përmbaruesit, këta përmbarues tani janë bërë më të fuqishëm se sa Komuna dhe Qeveria e Kosovës, deri më tani besoj se jemi duke shkuar në hapa të mirë, pra prioriteti i lartë i Komunës është kryerja e obligimeve. Shpresojmë se nuk do të ballafaqohemi me ato rezultate që po i kanë gjitha Komunat e Kosovës nga përmbaruesit privat. Parimisht jam duke folur natyrisht se është dashur të hymë në disa projekte e të reja për shkak të reziqeve të tjera të cilat do të paraqiten supozojmë në se ne nuk ndërmarrim hapa të caktuar në një projekt i cili ka mbetur pezull që disa vite pa e fajësuar askënd, ne me këtë rrezikojmë që mos të arsyetojmë qëllimin se pse është

investuar këto projekte. Në situata të tjera ne mundemi të ju informojmë pse janë përzgjedhur 2 - 3 kode dhe cili është arsyetimi bazik i hapjes së këtyre kodeve të reja.

Ali Morina – Flas në emër të grupit të Kuvendarëve të AAK-së, ne jemi pro këtyre bartjeve po ashtu i mbështesim edhe këto projekt të reja, kishte me qen mirë ndoshta që fotografitë nga gjendja momentale e këtyre projekteve të paraqiten në projektor në mënyrë që të shohin të gjithë Kuvendarë se në çfarë gjendje janë këto asete të Komunës.

Kryesuesi – E qes votim Shqyrtimin dhe aprovimin e bartjes së të hyrave vetanake nga viti 2017-2018: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 4 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i Raportit Financiar të vitit 2017.

Afrim Limani – Siç e di i të nderuar Kuvendarë unë e kam trashëguar këtë raport të disa ngjarjeve që kanë ndodhur në vitin 2017, tani më takon mua që të bëjë raportimin e këtyre ngjarjeve. Me sinjeritetin më të madh këtë raport do ta prezantoj në mënyrën më të mirë të mundshme, duhet që ta keni një informatë me rëndësi ky raport është i harmonizuar me departamentin e thesarit të Ministrisë së Financave. Ky raport përbëhet nga dy komponentë nga të hyrat dhe të dalurat, të hyrat gjatë vitit 2017 nuk kanë qen në masën e kënaqshme të realizimit sepse ka një ndryshim ose një rrënjë në krahasim me vitin 2016 përafërsisht 56,000.00 €, kurse shpenzimi i buxhetit për vitin 2017 ka qenë në një formë të kënaqshme dhe të mirë diku në masën prej 97% që vlen të kuptojmë që asnjë mjet nuk ka shkuar në suficit. Pjesa nga 94 % të realizimit nga investimet kapitale, kurse pjesa e mbetur prej 6% është nga të hyrat vetanake të cilat do të barten këtë vit, pastaj janë dy muaj të realizimit të hyrave për shkak të mbylljes së viti fiskal dhe ato mjete nuk kanë pasur mundësi të futen në projekte të caktuara. Në faqe nr. 19 në shtyllën e fundit do ju japë një sqarim, në mënyrën vertikale unë i kam paraqitur obligimet të bartura në vitin 2018, nuk kam dashur të ju tregoj se sa borxhe kemi trashëguar, por kam dashur të arsyetoj atë se pse raporti 3 mujor për vitin 2018 do të jetë i fryrë sepse ne kemi filluar dhe kemi bërë mos të ethëm ndoshta 50% të këtyre obligimeve, pra raporti 3 mujor për vitin 2018 do të jetë i fryrë me disa shpenzime. Krejt në fund e keni një rekapitullim të gjitha shpenzimeve të cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2017, obligimet financiare për mallra dhe shërbime kanë qenë 168,634.92 €, shpenzimet komunale kanë qen 18,448.54 €, në subvencione kanë qen 8,457.70 €, në investime kapitale 2,048,0135.00 €, që gjithsej kanë qenë 2,243,676.94 €. Tabela e fundit për transparencë ku e kamë bërë një rekapitullim të gjitha borxheve apo shpenzimeve të cilat janë paraqitur ndër vite, duke filluar nga viti 2012 gjer në vitin 2017, fjala është vetëm për obligimet financiare, borxhi total është 2,044.30.29 € kurse obligimet kontraktuale janë 6,703.896.52 €, për këtë pjesë të borxheve i kam të paraqitura edhe me informatën financiare, pra nëse pajtoheni këtë mundemi ta diskutojmë në pikën e radhës.

Flori Boshnjaku – Edhe në KPF e kam cekur shpresoj se nuk na ndodhë neve sikurse qeverisjes së kaluar të cilët gjithmonë janë ankuar siç e thoshte mësuesja z. Rukije që vajtonin se i kemi lënë borxhe, jam duke parë se një shumë e madhe e obligimeve financiare dhe kontraktuale kanë mbetur por pa dashur askënd me e kritikuar, shpresoj se qeverisja aktuale do ti mbulojë këto shpenzime dhe do të gjejë mjete dhe forma për ti kryer të gjitha këto obligime sepse çdo qeveri e cila vjen duhet që ti merë të drejtat dhe obligimet e jo ti merë vetëm të drejtat kurse obligimet jo. Qeverisja e kaluar ka thënë se ata kur do ta lënë mandatin borxhi do të jetë zero por siç jemi duke parë kjo nuk ka ndodhur, siç jemi duke parë diku ma shumë se 2 milion janë obligime të faturuara financiare, më shumë se 6 milion janë obligime kontraktuale, nuk jam duke kritikuar pse kanë lënë obligime kontraktuale e kam cekë edhe atëherë po e cekë edhe tani asnjë projekt nuk kryhet për një vit, projektet mundem me qen 3 vjeçare por qeverisja e kaluar ka premtuar se nuk do të bëjmë na kështu siç kanë bërë këta. Shpresoj se qeverisja aktuale nuk ankohet si ata dhe i kryen të gjitha punët sipas ligjit dhe akteve tjera në fuqi. Tjetra që kisha me kërkuar nga Drejtori për Buxhet dhe Financa është që ta kemi Planin Kesh sepse secili nga ne do të pyes pse nuk është duke filluar ky projekt pa e ditur se kur alukohen ato mjete, prandaj është mirë që secili anëtar i Kuvendit ta ketë Planin Kesh për vitin 2018 dhe me pa se kur i kanë parapa dhe në cilin muaj alukohen mjetet dhe në cilën kohë mundën me të ja fillojnë me shpalljen e tenderëve. I nderuari Drejtor në faqe të fundit e kam një pyetje tek fatura e dt.14.04.2015 projekti kubëzimi i trotuareve në rrugën “Abdullah Bugari” dhe “Mizahir

Isma” nuk janë të përfshirë në listën e kontratave dhe është projekt i viti 2010, a është ky obligim i faturuar apo vetëm obligim kontraktual.

Ali Morina – Raporti Financiar i vitit 2017 konstaton borxhe të larta të trashëguara nga qeverisja e kaluar, sipas këtij raporti konstatohet se janë borxhe kontraktuale mbi 6 milion €, kurse borxhe të faturuara mbi 2 milion € këto janë shifra shqetësuese. Brenda këtij raporti gjejmë shpenzime enorme në disa lëmi ku do i potencoj unë disa nga to, tek kodi 13320 shpenzimet e telefonit ku janë shpenzuar mbi 9,000.00 nga kjo kategori del që të jemi borxh 1,345,53 €, pse kemi një rritje të këtillë tek shpenzimet e telefonit, tek kodi 13380 shërbimet postare ku borxhi është mbi 8,000.00 € diferenca nga viti paraprak mbi 6,000.00 € dhe po ashtu nga kjo kontratë del që të kemi borxh të faturuar mbi 10,000.00 €. Kodi 14010 riparimi i automjeteve është 21,000.00 € diferenca nga viti paraprak është 3,200.00 € si dhe borxhi i faturuar është mbi 14,000.00 €, çka ka ndodhur me këto vetura ku çdo vite janë shpenzuar shuma të këtilla për riparim mua kjo më duket shumë e pa arsyeshme. Kodi 14310 dreka zyrtare, në vitin 2016 kemi pasur 4,200.00 € kurse në vitin 2017 kemi rritje prej 9,699.20 € pra një diferencë nga viti paraprak prej 5,496.50 €, nga kjo del që të jetë borxhi i faturuar pothuajse 100%, i nderuari Drejtor a mundeni të më sqaroni se a ka qenë e paguar ndonjë faturë nga viti i kaluar apo jo, nëse është paguar a ka mundësi që kjo shifër të dyfishohet apo të rritet.

Fehmi Cena – Kur jemi tek raporti financiar i vitit 2017 në shëndetësi dua një sqarim nga Drejtori për Financa, të hyrat ceket këtu se janë 36,412.17 €, një pjesë e këtyre mjete rrjedhin nga sistemi i informimit shëndetësor, sa për informim për delegatët për çdo pacient që ne kemi regjistruar në formën elektronike Banka Botërore ka inkasuar 2.4 €, dua ta di që kjo pjesë e buxhetit a është në kuadër të shëndetësisë apo jo dhe sa është shuma e përgjithshme për vitin 2017 dhe a është në dijeni Drejtori i ri nëse po të na sqaroj ose sot ose në mbledhjen e ardhshme.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, jam duke parë që AAK është duke kritikuar vazhdimisht grupin e PDK-së për obligimet financiare të cilat i kanë pasur ndër vite, pra këto dy subjekte janë duke u akuzuar njëra tjetrën. Nuk jam duke parë një plan konkret nga ana e qeverisë aktuale se cili do të jetë një plan për shlyerjen e këtyre borxheve, këto borxhe janë jashtëzakonisht të mëdha për Komunën e Rahovecit, pra nuk na është ofruar një plan konkret qoftë në baza mujore ose vjetore pra të ketë një sistem financiar karshi shlyerjes së këtyre borxheve.

Rasim Fazliu – Sa për informatë për kolegët dhe qytetarët e Komunës së Rahovecit, është mirë që të dallohet se çka janë borxhet me kontrata dhe çka janë obligimet financiare që janë të faturuara të cilat janë në pritje. Ne kemi projekte që janë 3-4 vjeçare sipas kornizës buxhetore dhe është shumë normale që të parashihen mjetet edhe për vitin 2018-2019-2020 dhe këto nuk munden me u quajtur borxhe sepse të gjitha projektet janë të parapara, neve na mbetet vetëm që të realizohen këto projekte dhe këto nuk mundemi me i quajtur borxhe. Është edhe diçka interesante të ceket se nuk kemi kontrata sikurse në qeverisjet e kaluara të cilat i kanë nënshkruar kontratat pa pasur mbulesë buxhetore, kurse ne i kemi paraparë të gjitha ato do të paguhet kur ti vije koha.

Ali Morina – Desha të bëjë një sqarim të vogël, gjatë qeverisjes së kaluar të AAK-së ne jemi goditur pikërisht në këtë që e tha z. Fazliu sepse ky 6 milionëshi si obligim kontraktual i nderuari thotë se nuk është borxh, kurse kur ne thoshim se ky nuk është borxh sepse vetëm borxhet e faturuara janë borxhet reale të Komunës së Rahovecit këta thoshin se i kemi lënë borxh 6-8 milion €, pastaj më vonë kanë rënë në 2 milion €, realisht borxhi në Komunën e Rahovecit në qeverisjen e kaluar të z. Smajl Latifi ishte 600,000.00 €.

Rasim Fazliu – Po e cekim edhe një herë se ne i kemi borxhe me kontrata por mjetet për këto kontrata janë të rezervuara. Por tash pse e mora fjalën është kjo me këqyrë pak popullorçe ne jemi në kornizat e buxhetit që kemi pasur ta shfrytëzojmë si qeverisje komunale, pra na keni lënë ma shumë se 2 milion borxhe edhe ne ju kemi lënë juve më shumë se 2 milion borxhe pra jemi fifty - fifty që thonë.

Sali Sallteku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po i them kolegut time z. Ali Morinës që nuk e paskan informuar bash mirë, i nderuar në qeverisjen paraprake nuk kanë qenë mjetet e buxhetuara kurse tani janë mjetet e buxhetuara, më vije keq që znj. Florije nuk e ka kolegën më por e ka tash thuajse të njëjtën si ajo nga Ratkoci ka qenë ajo nga Ratkoci është ky vetëm se gjini e kundërt. I nderuar vetëm për shpenzime të telefonave kanë mbetur

borxhe dhe ne me këto pastaj i kemi mbuluar shpenzimet e varrimit, nuk dua të replikë me askënd por shpenzimet e telefonit në qeverisjen tonë kanë rënë mbi 50 %, ju lutem merrni dhe krahasoni.

Florijs Boshnjaku – Faleminderit koleg nuk dua të bëjë replikë por e falënderoj shumë kolegun që është duke ma përmendur emrin dhe që i dinë të gjitha dhe që është duke më përkrahur dhe që është duke më dhënë sqarime, nuk është mirë të përmendet dikush kur nuk është prezent a ka shok apo jo unë e di, për mua i nderuari koleg je i nderuar ashtu siç ke qen dhe nuk e kam ndërmend me asnjërin nga ju të shtyhem, mendimin që e kam pasur në të kaluarën dhe tani që e kam jam gati që të jap çdo herë, në mënyrë profesionale kam ndihmuar dhe prapë do i ndihmoj, por shqen time nuk ka nevojë me e përmend kur nuk është prezentë.

Sali Sallteku – Më vije keq unë kam respekt për ju po ashtu gjithmonë ke qen konstruktive,, nuk ta përmenda unë shqen por ju e përmendët vet, por ju vet e thatë se kemi vajtuar 3-4 vite kjo ka qen arsyeja pse e kam bërë replikën për asgjë tjetër.

Kryesuesi – Sa e pashë një pjesë e pyetjeve u ndërlihdeshin me pikën e 6 të rendit të ditës kishte me qen mirë që pastaj të i përgjigjeni pyetjeve.

Afrim Limani – Do i përgjigjem së pari disa pyetjeve që i bënë disa Kuvendarë, e nderuara znj. Florije Boshnjaku e kërkoi Planin Kesh, e nderuar Plani Kesh ndahet në katër periudha ne e kemi Planin Kesh të periudhës së parë por gjithsesi në mbledhjen e radhës do ta kesh. Z. Ali Morina i potencoi disa lloje të shpenzimeve, e thash qysh në fillim se unë nuk dua të them asgjë në lidhje me këto shpenzime janë shënimet dhe ato janë borxhe reale dhe ky raporte është i harmonizuar me MF dhe nuk dua të komentoj më shumë për këtë. Z. Fehmi Cena bërë pyetje por këtë përgjigje e konsideroj që më mirë të ja japë në mbledhjen e radhës. Z. Ali Zhuniqi për mua besoj se e bëri pyetjen më interesante, i nderuar në fund e kam një njoftim ose një kërkesë për të gjithë ju Kuvendarë dhe aty do të jetë edhe përgjigja juaj. Z. Rasim Fazliu tha se duhet që të bëhet dallimi në mes të borxheve Kontraktuale dhe financiare, borxh financiar është ai borxh kur është kryer një punë një shërbim ose një veprim kur te ne ka ardhur fatura e gatshme, nëse ne nuk kemi mjete që ta financojmë atë faturë atëherë kjo është obligim financiar, kurse obligimet kontraktuale janë obligimet në proces, pra kur kemi një kontratë 3 vjeçare. Do ju shpjegoj një karakteristik që më ka ndihur mua tani, shumë operator nuk i kanë sjellë faturat në zyrën e prokurimit, shtohet pyetje pse nuk i kanë sjellë, nuk i kanë sjellë sepse në momentin e dorëzimit të faturës në Drejtorin e Financave atëherë ai hynë në obligime financiare ndaj ATK-së e pastaj është i obliguar që ta paguaj TVSH 18 %, pra kjo është arsyeja.

Kryesuesi – Ju faleminderit Drejtor kalojmë tani në pikën e 6 të rendit të ditës:

6. Informatë Financiare mbi obligimet kontraktuale dhe financiare 2012-2017.

Afrim Limani – Të nderuar e kam bërë një rekapitullim ndër vite nga viti 2012 -2017, për të gjitha projektet që kemi obligime edhe kontraktuale edhe financiare, për informatë më të sakët për ju në një shtyllë e kam futë edhe buxhetin e viti 2018 që nënkupton që ky buxhet e zbret edhe pjesën e borxhit, kurse shtylla e parafundit mbetjet pas pagesave me buxhetin e vitit 2018 në fund i bie pas mbulesës së buxhetit 2018 na mbesin obligime 3,553,393.00 € që i bie që me këtë situatë dhe në këtë gjendja aktuale të financave që e kemi planifikimi i buxhetit për vitin 2018 ekskluzivisht duhet që të orientohet në këto projekte. Ne i kemi adresuar kërkesat në Ministrin e ndryshme të linjës dhe besoj se ministrin do na bëjnë ndonjë alukim që sadopak të zbutet.

Mirjeta Krasniqi – Ju faleminderit për informatën që na keni sjellë, ndoshta nuk është në përgjegjësin e Drejtorit por kisha kërkuar që këto projekt që janë rreth gjysmë milioni të shihen sa janë duke u mirëmbajtur sa janë kryer si duhet, p.sh e kemi ndërtimin e Kompleksin Ndërtimorë Dëshmorët e Kombit në vlerën prej gjysmë milioni, si duket këtu nuk kemi obligime për këtë kod, dua ta di a ka ndonjë kompani që përkujdeset për mirëmbajtjen e këtij kompleksi. Po ashtu kodet e tjera si kanali i kullimit të tokave bujqësore në Celin, Ratkoc sa janë funksionale dhe nëse janë funksionale pse janë duke u bërë këto përmbajtje.

Rexhep Oruqi – Jam shumë i vetëdijshëm që informatë është bërë me kërkesën e dikujt nga Kuvendarët e AAK-së, po diçka nuk e kam të qartë, cili kriter është marrë për bazë për caktimin e periudhës së raportimit, jam duke parë vitin 2012 dhe përfundimin e vitit 2017, a është marrë mandati paraprak i z. Smajl Latifi dhe mandati i tërësishëm ish Kryetarit Vehapi, por mendoj se është kërkuar që të raportohet vetëm mandati i z. Idriz Vehapit e

jo edhe ish mandati i z. Smajl Latifi, por pasi është përfshirë edhe mandati i parë i z. Smajl Latifi atëherë ku ka mbetur viti 2011 po ashtu edhe ky vit ka qen mandati i z. Smajl Latifi, prandaj thjeshtë dua ta di pse nuk është përfshi edhe ky vit për raportim sa për informim të detajuar.

Afrim Limani – I nderuar z. Rexhep Oruqi e thash qysh në fillim se për arsye të transparencës i kemi futur të gjitha vitet në të cilat kemi obligime kontraktuale ose financiare, obligimet kontraktuale dhe financiare fillojnë nga viti 2012, kurse vitet e mëparshme nuk kemi pasur obligime dhe për këtë arsye nuk e kemi futur në këtë informatë. Personalisht kam mundur mos me fut vitin 2012 – 2013 por është dashur për shkak të transparencës, por prapë për hatër të transparencës po ju tregoj që e kemi pasur edhe një faturë nga viti 2010 në vlerë prej 3,775.00 €, por nuk kemi dashur që për një faturë ta fusim komplet vitin dhe kemi filluar nga viti 2012 dhe brenda kësaj periudhe kemi pasur obligime kontraktuale dhe obligime financiare.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë në pikën e gjashtë, kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi i raportit të auditimit të brendshëm për shëndetësi.

Binak Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, njësia e auditimit të brendshëm raportin final për Drejtorin e Shëndetësisë kryesisht në QKMF e ka kryer në bazë të planit vjetor të viti 2017, ky raporte është nga periudha kohore nga data 01.05.2017 – 09.06.2017, ky raporte është nr.3 në bazë të planit vjetor ku janë përfshirë rezultatet, objektivat. Në këtë raport janë përfshi 8 objektiva si objektiv kryesor kanë qen të hyrat vetanake në QKMF, nga objektivat kemi pasur edhe të gjetura ku në bazë të gjeturave kemi dhënë 6 rekomandime ku shumica janë implementuar nga manaxhmenti i QKMF-së, kaq sa i përket meje nëse keni ndonjë pyetje besoj se mundet me ju dhënë përgjigje edhe ish drejtori i Shëndetësisë pasi është prezent.

Ali Zhuniqi – Raporti i auditimit për vitin 2017 duke përfshirë periudhën 01.05.2017 – 09.06.2017 tregon që është një raport kryesisht që raporton në mënyrë negative dhe përafërsisht tregon jo seriozitetin e punës së ish Drejtorit të Shëndetësisë, pak më herët e ceku edhe z. Fehmi Cena se është një problem sa i përket sistemit të Informimit softuerik sa i përket çështjes së pagesave, ku cekët edhe këtu se të gjitha rekomandimet janë pothuajse negative ku secila parti ja lenë fajin njëra tjetrës, kam një pyetje konkrete sa i përket këtij shqetësimi: A është i informuar me këtë prishje Drejtoria dhe nëse po a janë ndërmarrë hapat konkrete nga ardhja e qeverisë së z. Smajl Latifi dhe cilat janë këto hapa për ti ndaluar këto keqpërdorime financiare qoftë me dëftesa të cilat lëshohen vazhdimisht nëpër Qendra të Mjekësisë Familjare po ashtu zyrtari financiar i cili është në kuadër të QKMF-së a ka pasur kontakte me ta dhe cilat janë masat që duhet ti ndermirë Drejtoi i Shëndetësisë kur i sheh këto keqpërdorimet financiare karshi personit i cili është përgjegjës për atë punë.

Florije Boshnjaku – Falënderoj zyrën e auditimit që na ka sjellë këtë raport, ne edhe në të kaluarën e kemi kërkuar që të na silllet brenda vitit sepse tani shumë shpejtë do na vije edhe raporti i auditimit të përgjithshëm që shumë pak ka rëndësi, ky raporte është 3 mujor por të nderuar kolegë kur të na sillni raportin duhet që ti keni disa gjëra të qarta, pa keqkuptime për zyrën e auditorit të brendshëm. Ky raport qysh në fagen e parë shkruan Auditimi i Brendshëm në Drejtorin e Shëndetësisë, duhet që ti shtohet dhe Mirëqenies Sociale, pastaj nën dy ky raporte kur u nda në departamente nuk është i bazuar në Statutin e qendrës së Mjekësisë Familjare “Dr. Fahredin Hoti”, pra është dashur në dy departamente të jetë në Barnatore dhe Materniteti, kurse ju e keni quajtur departamente, raportet e tjera kur të na vinë duhet që të bazohen në Statut sepse këtu janë thirrur kinse janë bazuar edhe në Statut. Nëse është kryer auditimi i Drejtorisë për Shëndetësi dhe jo vetëm i QKMF-së sepse këtu kemi ehe ndarje të subvencioneve, prandaj kishte me qen mirë që edhe ne të kemi një raporte më të qartë dhe raporti të na silllet brenda vitit, ky është raport për 3 mujorin e vitit 2017 kurse ne jemi tani në 3 mujorin e parë të vitit 2018. Pastaj ky raporte nuk është i nënshkruar nga auditorët, nëse është raporte final dhe i protokolluar atëherë duhet që të jetë edhe i nënshkruar sepse është një dokument zyrtar. Nuk e kam pas që të bëjë kritika por që të kontribuoj në mënyrë që raportet e ardhshme të na vinë më të kompletuar.

Munib Durguti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, lidhur me raportin e auditorit për shëndetësi, në disa raste ceket 3 mujor në disa raste e ceku 6 mujor, kemi shumë vërejtje se si është sjellë ky raport dhe të gjeturat që janë nxjerrë nga auditimi. Në radhë të parë auditori shumë pak e njeht strukturën e institucionit, aty përmenden 5 departament të mjekësisë familjare, pastaj thirret në Statut siç e ceku edhe znj. Florije, në Statut janë dy

departamente kurse të tjerët janë njësi dhe sektorë. Pastaj pas këtij raporti ne kemi pasur mbledhje me menaxhmentin e QKMF-së ku i kemi shqyrtuar këto të gjeturat e auditimit dhe menjëherë disa të gjetura i kemi adresuar në mënyrë që të arrimë një performancë sa më të mirë dhe këto të përmirësohen dhe që në të ardhmen mos të përsëriten përsëri. Do të vazhdoja me rekomandimin nr.1 të cilin e ceku edhe auditori, ku numërohen disa lëshime në procedurë ku në raport janë paraqitur si prioritet i mesëm, duke e cilësuar si shmangie nga procedura në disa raste, disa reshta më poshtë i njëjti e konfirmon se në krahasim me vitin 2016 kemi rritje 26%, tani unë ju bëj pyetje të gjithëve a kemi të bëjmë më lëshime dështime apo kemi të bëjmë për rezultate apo arritje sepse 26% për një 3 mujor të ritet participimi është një arritje shumë e madhe ju të gjithë e keni pasur raportin financiar para vete dhe e keni parë që participimi është në nivel mjaftë të mirë. Sa i përket subvencioneve komunale dhe afateve të tyre mendoj se në subvencione shëndetësia ka një sfidë mjaftë të madhe për stafin e vogël që numëron kjo drejtori, shpesh herë pothuajse është e pamundur të zbatohet në përpikëri afatet e caktuar me rregulloren komunale për subvencione dhe atë për çështje praktike, do i numëroj unë vetëm disa, ndodhë që kërkesa të jetë shumë urgjente nga pala kurse drejtorja nuk ka fare buxhet për ti ju përgjigjur palës me një përgjigje pozitive, rregullorja cakton një afat prej 15 dite kurse ne duhet që të presim alukimin e buxhetit pas 1-2 muaj, kështu kanë qen praktikat dhe kjo është përvojë në të cilën kemi hasur në vështirësi. Po ashtu është e pamundur unë në vazhdimësi e kam ngritur këtë çështje sepse komisioni për ndarjen e subvencioneve në shëndetësi të mbledhet çdo 15 ditë ashtu siç e përcakton rregullorja, këtë auditori e ka gjetur si çështje e shmangies apo lëshim dhe e ka ngritur sepse është e drejta e tij. Rekomandimi nr.4 Barnat Esenciale, auditori e përmend që në disa raste, në momentin kur bëhet shpërndarja e barnave esenciale nga barnatoret qendrore në punët shëndetësore ajo evidentohet me një faturë të detajuar mirëpo vetëm duke përfshirë në të sasinë dhe numrin e barnave dhe emërtimin e barnave por jo edhe vlerën monetare. Gjatë takimit me shefin e barnatores dhe ekipin atje ne kemi hasur se ata janë duke përdorur një sistem unik që është duke u aplikuar në tërë Kosovën dhe nuk është praktik në asnjë rrethane që në momentin kur të shpërndahen barnat personeli apo tekniku të përfshihet edhe vlera monetare, kjo ka qen për çështje praktike përndryshe sa herë është ngarkuar një personel me barna në këtë raste farmacisti e ka pas edhe faturën me ngarkesë në vlerë monetare, atë faturë ai e përfshin në secilin raport mujor kur i raporton Drejtorisë për Shëndetësi dhe Ministrisë përkatëse. Po ashtu ata kanë vërejtje tek auditori sepse auditori në momentin kur vjen nuk e zhvillon një komunikim të mirëfilltë në mënyrë që vërejtjet apo lëshimet që i gjen në sektor to adresoj aty për aty por ai vetëm e merë materialin dhe e bënë një komunikim shumë të ftohtë dhe në fund del edhe me një raport i cili mund të jetë edhe i disfavorshëm, mirëpo kjo është e vërteta aty kemi raporte mujore, kemi po ashtu ato që janë përmendur ata nuk pajtohen me asnjë rast që nuk bëhet regjistrimi i stokeve në fund të vitit ato i kemi të rregullta dhe janë raportet mund ti merrni dhe ti prezantoni në seancën e radhës. Rekomandimi Nr.6 veturat e autoambulancës, e keni parë se aty përmendet që kemi shmangur nga rregullorja, do ja kisha bërë një pyetje konkrete auditorit ngase jam i bindur se këtë sektor e kemi rregulluar mjaftë mirë dhe i tëri funksionon në bazë të rregullores në fuqi, ne kemi një shef të autoparkut i cili ka dhënë rezultate mjaftë pozitive, kemi ulë shpenzime në mirëmbajtjen e veturave po ashtu kemi ulë shpenzimet e Karburanteve, ky ka qen hapi i parë kur e kam marrë postin e Drejtorit asnjë autoambulancë nuk ka pasur mundësi që të dele nga oborri i QKMF-së pa udhëzim të mjekut. Përndryshe flasin edhe raportet financiare për shpenzimet që i kemi bërë në mirëmbajtjen e këtyre veturave ku kanë qen 150% më pak se ato që i kam trashëguar, prandaj unë nuk pajtohem aspak me këtë auditim që na është prezantuar. Sa i përket participimit edhe kolegu e ngriti çështjen që kemi keqpërdorime, mundem të them se participimi ka qen një segment që ka shënuar mjaftë suksese të mëdha vit pas viti, ne kemi pasur një participim ma shumë se 36,000.00 € në vitin 2017, në krahasim me vitin 2016 kemi një rritje të vogël, por në 2017 ne kemi pasur 7900 pacientë më pak që do të thotë se prapë flitet për një rritje vite pas viti.

Fahrije Lushi morina – Do të ndërlihem rreth shëndetësisë ku si pikë kryesore e kam Gjinekologjinë gjithmonë duke u bazuar në historikun që është bërë nga auditori dhe renditjen e drejtë që i adresohet një auditimi përkatës duke mare parasysh disa pika të cekur që janë aty, dua ta di që tani e tutje a do të funksionoj kujdesi shëndetësor prodhues që përfshin kujdesin shëndetësorë gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonave ku deri më tani

shëndetësor prodhues që përfshin kujdesin shëndetësorë gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonave ku deri më tani funksionon vetëm me një mjek, a do të ketë më shumë mjek dhe si do të realizohet në mënyrë më të drejtë kur e dimë se shumica e lindjeve kryhen zakonisht jashtë Rahovecit.

Fehmi Cena – E kam lexuar me kujdes këtë raport dhe i njoh rrethanat se si janë këtu në shëndetësi sepse jam mjekë në QKMF, këto vërejtje që i dhanë parafolësit z. Munib Durguti dhe znj. Florije Boshnjaku aty nuk do të ndalem rreth strukturës organizative ku ceket statuti i QKMF-së a ka gabime ata i cekën sepse asgjë nuk ka ndryshuar që nga ajo kohë, këta dy e njohin gjendjen sepse kanë qen edhe vetë drejtorë Komunal sikurse një kohë që kam qen edhe unë. Tek faqe nr.8 do të isha kyçur pak tek të hyrat ku ceket se QKMF-ja realizon të hyrat nga participimi po ashtu ceken edhe certifikatat e tjera, besoj se ju të gjithë e dini se çka paguhet në QKMF është shërbimi i mjekut familjar, stomatologut, rëntgeni, analizat laboratorike disa dhe disa certifikata shëndetësore për punësim kohëve të fundit janë duke i kërkuar mjaftë shumë për viza, do i kisha përmend certifikatat të cilat tani nuk i lëshon QKMF-ja e ato janë certifikatat për Patentë Shofer, në të kaluarën ka ekzistuar komisioni mjekësor shëndetësor për lëshimin e certifikatave shëndetësore për patentë shofer pranë QKMF-së, por që nga viti 2008 nuk ekziston më, në atë kohë Drejtori i shëndetësisë i patë ndërprerë funksionimin e këtij komisioni në mënyrë arbitrare por pastaj nuk ka mundur më ta formoj. Ky komision është me rëndësi sepse i kryen shërbime qytetarëve dhe nuk do të kenë nevojë qytetarët tanë të shkojnë në Prizren, Gjakovë ose Malishevë, por më e rëndësishmja është se grumbullon edhe të hyrat. Kisha kërkuar nga Drejtori i Shëndetësisë nëse ka mundësi që për mbledhjen e ardhshme që të na jep një informacion në lidhje me këtë komision, ka zëra se ne nuk kemi të drejtë ta formojmë këtë komision, por kishte me qen mirë që të hulumtohet në mënyrë që në të ardhmen Komuna e Rahovecit ta ketë një komision të tillë për arsyet që i ceka më lartë. Kur jemi tek rekomandimet pajtohem me parafolësin z. Munib Durgutin janë disa rekomandime konkretisht 6 nuk është se situata është shumë e keqe në fakt shumë gjëra janë mesatare, disa edhe janë përmirësuar por ajo çka i mungon këtij raporti mendoj se është dashur edhe drejtoria ta ketë pjesën e vetë shtesë me shkrimë për këtë raport, auditori shumë mirë e ka paraqitur në mënyrë tabelore në dy faqe të fundit që janë veprime e menaxhmentit, datat e planifikuar të kompletimit dhe përgjegjësit, në mënyrë që ne saktësisht ta dimë se çka është përmirësuar dhe çka ka me u përmirësuar. Kishte me qen mirë që kjo të mbetet praktik për të ardhmen, kishte me qen mirë që Drejtoria Komunale të ulet me menaxhmentin e QKMF-së që ta shqyrtoj çdo raport të auditimit.

Ali Morina – Raporti i auditimit të brendshëm i QKMF-së edhe pse nuk vijë nga kjo sferë mua më u duk ky raport shumë përfaqësorë, e respektoj vendimin e Doktorit sepse ka një përvojë bukur të gjatë në sektorin e shëndetësisë. Do të filloj nga planifikimi i të hyrave vetanake ku janë planifikuar që të inkasohen 61,000.00 €, kurse nga kjo shumë ka arritur që të inkasohet vetëm 10,227.30 €, për mendimin time është një planifikim jo real dhe jo serioz është mundur që të planifikohet deri në 20,000.00 € dhe të inkasohen deri në 40% ose 50%, është mirë që të bëhen planifikimet sa ma reale. Tek subvencionimi i pacienteve me mjete financiare me ndihmë momentale si proces ka zgjatur 5 muaj që është një maltretim për parashtruesit e kërkesave, po ashtu mos protokollimi i kërkesave dhe konfirmimeve tregon një neglizhencë papërgjegjësi dhe mundësi të keqpërdorimit të këtyre mjeteve. Furnizimi me barëra nuk është i kënaqshëm sasitë e barnave të dorëzuar qoftë nga ministria qoftë nga Komuna nuk janë të mjaftueshme as për 50% të kërkesave që kanë qytetarët tanë, mendoj se në këtë raport përveç një çmimi që janë paraqitur të dhënat është dashur që të na paraqiten edhe në sasi sepse nuk e dimë se sa ilaçe ka pranuar QKMF-ja. Po i mare disa shembuj konkret në AMF-në e Ratkocit, brenda një muaji pranohen sasi shumë të vogla të ilaçeve ku në ditë ka deri në 65 pacientë, pranohen 100 ampula Diklofen, 100 ampula Diazepam, 10 shishe me NaCl, 10 shishe Glukoz, e mos të flasim për ilaçe të sëmundjeve kronike që vinë me sasi shumë të vogla dhe nuk mjaftojnë as për një javë e mos të flasim për një muaj. I bëj thirrje menaxhmentit aktual që të merën seriozisht me këtë temë dhe të orientohen më shumë tek furnizimi me barëra në mënyrë që të plotësohen sa më tepër kërkesat e qytetarëve.

Mirjeta Krasniqi – Përveç vërejtjeve që parafolësit i dhanë ku pajtohem plotësisht me ta, kisha sugjeruar auditorin që këtë material ta përpunoj edhe një herë dhe ato lëshime teknike ose gabime drejtshkrimore me apo pa

Binak Kryeziu – Tek rekomandimi nr. 6 që e ceku ish drejtori rekomandojmë që urdhëresat dhe raportet mujore të evidentohen kilometrat e sakta të përfunduar gjatë çdo përfundim të udhëtimit. Drejtorët raportin mujorë e kanë paraqitur në Drejtori në këtë raporte duhet që të paraqesin kilometrazhin e automjeteve, i nderuar ka kilometra të shtuara p.sh deri në Prizren i kanë shtuar 10 Km ma shumë. Menaxhmenti në të ardhmen të ketë kujdesë që të bëjë kontrolle dhe mos të shtohen kilometrat sepse aty krijohen shpenzimet. Sa i përket lëshimeve teknike munden të ndodhin por do ti përmirësojmë, po ashtu saç i përket nënshkrimit çdo raporte nënshkruhet por nuk e di se si ka kaluar ky pa u nënshkruar, po ashtu është gabimi ynë sepse është dashur të cekët edhe Mirëqenia Sociale është një vërejtje me vend që na e ka dhënë znj. Florije. Këtë raporte nuk e kam paraqitur unë në kuvend këtë raport e ka sjellë menaxhmenti i tanishëm.

Munib Durguti – Pa keqkuptime me auditorin sepse ai e kryen punën e vetë ku na tregon rrugën të cilën ne duhet që të ndjekim. Mirëpo tek rekomandimi nr. 6 për veturat unë e kisha të paqartë se për cilën veturë bëhet fjalë sepse ai e ceku për veturën që përdoret nga menaxhmenti, ne i kemi dy vetura. Është puna e Drejtorit të ri që ta perfeksionoj këtë raport në të ardhmen.

Dervish Qadraku – ne për këtë auditim kemi biseduar edhe në KPF ky është një auditim të cilit i ka dalë ngjyra në kuptim e asaj që ne duhet të merremi me këtë punë, është 3 mujori i parë i vitit 2017 kjo ma shumë ka qen një lloj vërejtje i qeverisë së kaluar se deri ku kanë shkuar dhe deri ku kanë mundur të shkojnë, ne i kemi 6 rekomandime të këtij auditimi ku për mendimin tim ku nuk janë bash që nuk kanë shumë shkelje, qeverisja e tanishme duhet bukur shumë që ti jepe vërejtje në kuptimin e asaj që mos të shkelë në kësi lloj dërrasash që kanë ndodhur vitin e kaluar sepse ne në fakte ende nuk e dimë se çka ka ndodhur deri në fund të vitit. Por po shihet se këtu ka shkelje dhe ndoshta do të ketë ndonjë pasojë ma të rëndë gjatë auditimit të fund vitit, kemi blloqe të cilat nuk janë mbyllur, kemi keqpërdorimin e veturave e shumë të tjera dhe këto janë vërejtje që qeverisja e tanishme mos ti bëjë këso gabime.

Kryesuesi – Ju faleminderit nëse nuk ka më dikush të shtoj diçka më shumë kalojmë në pikën e radhës:

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit.

Samir Mustafa - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, duke u bazuar në nenin 11, nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës miratimin e vendimit me të cilën i lejohet Kryetarit të Komunës që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit të lidhë marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare të cilat veprojnë territorin e Komunës së Rahovecit. Pas konsultimit me Bashkësinë Islame pakoja e shërbimeve primare do të definohet me një marrëveshje të re e cila nuk mundet ta ketë koston më të lartë se 180.00 € për një rast, ndërsa shërbimet e tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes qytetarët janë të obliguar që ti sigurojnë personalisht. Pagesa do të bëhen nga kodi i mallrave dhe shërbimeve e jo si më herët që janë bërë nga subvencionet, ngase për shkak se janë bërë pagesat nga subvencionet studentët tanë kanë mbetur pa bursa 3 vite reshtë. Prandaj ju ftoj që ta përkrahni këtë vendim.

Rasim Fazliu – Të nderuar ne plotësisht e mbështesim propozimin e Kryetarit të Komunës për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit, kishte me qen mirë që tek pika Nr.2 ku ceket hapja e varrit, transporti i punëtorëve dhe mjeteve të punës të shtohet edhe mbulimi i varrit sepse pa këtë po duket si pak e cunguar kjo pikë, ne e dimë që nuk do ta lënë të hapur por kishte me qen më mirë që të ceket. Po ashtu kishte me qen mirë që mos të merremi çdo vite me këtë çështje prandaj propozoj në emër të grupit të PDK-së që të merret vendimi për komplet mandatin tuaj.

Ali Zhuniqi – Të njëjtin mendim e pata edhe unë sikurse parafolësi imë që ky vendim të votohet për një mandat 4 vjeçar duke e parë që edhe Komunitatet e tjera të Republikës së Kosovës e kanë një formë të tillë, prandaj edhe propozimi imë është që vendimi për mbulimin e shpenzimeve të varrimit të jetë për një mandat 4 vjeçar.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e mbështes po ashtu edhe unë vazhdimin e kësaj kontrate, por nëse kjo shumë mjafton kishte me qen mirë që të ju thuhet atyre që i kryen këto shërbime që mos të i kërkojnë ekstra pare familjarëve sepse e di një rastë që ju është kërkuar një familje shtesë 20.00 €.

Munib Durguti – PO ashtu edhe unë i bashkohem parafolësve dhe jam pro asaj që Kuvendi një herë e mirë të vendos për këtë çështje dhe mos ta kemi këtë temë, më herët kjo marrëveshje është mbuluar nga kodi i

subvencioneve deri sa e njëjta nuk ka figuruar në rregulloren për subvencione, tani besoj se është shumë më lehtë pasi do të mbulohet nga kodi i mallrave dhe shërbimeve dhe për këtë besoj se nuk ka nevojë që kuvendi të vendos vit pas viti. Sa i përket atyre që u ngritën unë mbaj përgjegjësi për kohën që e kam menaxhuar këtë marrëveshje për 3 vite nuk kam pasur asnjë ankesë nga palët që ata në një farë forme kanë abuzuar me këtë marrëveshje ndaj qytetarëve që kanë qenë shfrytëzues të kësaj mbështetje nga Kuvendi Komunal, qa më pak kur në kuadër të marrëveshjes kanë pasur edhe listën e shërbimeve ku obligohen që secilin qytetar ta informojnë me një fletushkë për pakon e shërbimeve që i mbulon Komuna, që nënkupton se çdo gjë që është përtej asaj qytetari është i obliguar vetë të paguaj. Kemi konfirmim që edhe ata janë të pajtimit me këto kushte dhe besoj se gjithçka është më se në rregull.

Dervish Qadraku – Edhe ne si grupe parlamentar i LVV-së pajtohemi me këtë propozim vendim, por kishte me qenë mirë siç e tha kolegu dhe në bisedë të lirë me disa që janë ndoshta kompetent për këtë punë që të ceket edhe mbyllja e varrit. Sa i përket çmimit mendoj se është adekuat dhe është shumë mirë që po bëhet kjo punë duke e parë krizën ekonomike të popullit të Kosovës është bërë edhe frikë edhe kur të vdes ndonjë i afërt sepse përpos mërzisë që e ke të nuk e dinë se si do i mbulosh këto shpenzime, prandaj ne si grupe e përkrahim këtë vendim.

Florijs Boshnjaku – Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës besoj se shumica janë që të vazhdojë kjo marrëveshje, po ashtu edhe unë isha pajtuar plotësisht që të mirët një herë ky vendim e mos të shqetësohemi çdo vit, por mendoj se ne nuk kemi të drejtë të marrim vendim më shumë se për një vit, për arsye se edhe kodi ka ndryshuar, procedurat po ndryshojnë dhe po kemi vërejtje nga auditorët. Prandaj mirë është që të marrim vendim edhe këtë vit për afat kohorë një vjeçar e shpresojmë se vitin e ardhshëm do të bëhet një rregullore dhe e marrim një vendim në fund të vitit sepse këto pagesa duhet të bëhen në mënyrë retroaktive e ne në muajin nëntor ose dhjetor duhet të marrim një vendim ose të hartojmë një rregullore.

Sali Sallteku – Pajtohem plotësisht me znj. Florijs Boshnjaku dhe e kuptoj se këto pagesa bëhen nga mallrat dhe shërbimet dhe është problem të merret një vendim më shumë se sa për një vit, mendoj se është i ulët pak ky çmim por pasi nuk ka buxhet dhe janë pajtuar të dyja palët për mua është në rregull. Prandaj propozoj që të shkohet me votim dhe mos të diskutojmë më gjatë këtë pikë.

Ali Morina – Gjithsesi se pajtohemi me këtë vendim, por kam një propozim nuk e di se sa mundet të aplikohet, që tek pika Nr.3 aty ku ceken dërrasat a nënkupton që në këtë pikë përfshihet edhe letra e zezë e cila në shumë raste aplikohet dhe nëse propozoj që të specifikohet në mënyrë mos të thonë pastaj jo ka qenë jo ska qenë e paraparë.

Nënkryetari – Përsëritje për të gjithë të pranishmit, vendimin besoj se e keni lexuar edhe pse nuk është diçka e re është përsëritje e vendimeve të kaluara, për këtë vit është paraparë vlera 180.00 € krejt kjo duke u bazuar në mundësitë buxhetore të Komunës dhe arsyeja tjetër ka qenë ndërimi i kodit nga subvencionet në Mallra dhe shërbime, kjo marrëveshje nuk mundet të lidhet në afat më të gjatë se një vit do të shohim se çka do të bëhet në vitin 2019 a do të zhvillohen procedurat e tjera apo do të shkohet prapë me vendim të Kuvendit. Ju të gjithë e dini se vendimi i vjetër ka skaduar me 31.12.2017 kurse tani jemi në fund të muajit mars prandaj pagesa do të jetë në mënyrë retroaktive, në këtë rast Kuvendi merret vendim dhe autorizon Kryetarin e Komunës që pagesa për Bashkësinë Islame për të gjitha rastet do të bëhet në mënyrë retroaktive duke filluar nga 1 janari i vitit 2018, gjithnjë duke mos harruar që Komuna i ka borxh Bashkësisë Islame afër 15,000.00 € për vitin 2017, nuk e di pse nuk është paguar prandaj duhet që të merret parasysh edhe ky borxh. Kurse sa i përket specifikacionit Bashkësia Islame i ka specifikuar qartë se cilat janë shërbimet, tash nëse kërkojmë ne më tepër shërbime jashtë këtij specifikacioni si letra e zezë ose diçka tjetër atëherë të gjitha këto janë të kushtueshme për Bashkësinë Islame. Prandaj unë pajtohem që në pikën 2 të shtohet edhe mbulimi i varrit dhe me këtë të jetë gjithçka në rregull, po ashtu kërkoj nga Drejtori i Financave që me pagesa të jemi me kohë për çdo rast.

Kryesuesi – E qes në votim Propozimin e Vendimit të Kryetarit të Komunës rreth shërbimeve të varrimit: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 8 (tetë) e rendit të ditës: Kalojmë në pikën e radhës:

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit 01 Nr. 585, rreth ndërtimit të palestrës sportive në Krushë të Madhe.

Kryesuesi - Desha vetëm të ju informojë se pika Nëntë dhe pika e Dhjetë bëjnë fjalë për të njëjtin problem dhe janë të ndërlidhura njëra me tjetrën. Në pikën e nëntë duhet të marrim vendim për të shfuqizuar vendimin e mëparshëm kurse në pikën e dhjetë na duhet që të marrim vendim për ndërtimin e palestrës në Krushë të Madhe.

Ervin Hoxha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket shfuqizimit të vendimit të dt. 28.02.2017 me protokollin Nr. 585 Kryetari i Komunës propozon që ky vendim të shfuqizohet për arsye se në parcelën me Nr. 524 ku është planifikuar të bëhet ndërtimi i palestrës sportive në Krushë të Madhe gjendet lapidari i dy dëshmorëve “Dalip Behra” dhe “Bekim Gashi” dhe në këtë parcelë nuk ka mundësi të ndërtohet palestra sportive. Kryetari i Komunës Propozon që për ndërtimin e kësaj palestre të shfrytëzohet parcela me Nr.253, pra në këtë rast vetëm duhet që të bëhet zëvendësimi i parcelave kurse procedurat e tjera nuk do të ndryshojnë. Të nderuar Kuvendarë ju ftoj që ti mbështesni këto dy pika së pari ta shfuqizoni një vendim dhe pastaj në pikën e 10 ta apromoni propozimin e Kryetarit të Komunës.

Rasim Fazliu – Ne edhe në KPF e kemi diskutuar këtë pikë dhe pasi na shpjeguan se një pjesë e banorëve të Krushës së Madhe e kanë kërkuar që të mos ndërtohet në këtë parcelë palestra për shkak të lapidarit, neve asgjë nuk na pengon prandaj ne jemi të pajtimit që të bëhet zëvendësimi i kësaj parcele.

Fehmi Cena – Edhe ne si grup i LDK-së jemi të pajtimit që të bëhet zhvendosja e ndërtimit të kësaj palestre, ashtu sikurse që kemi marrë vendim në KPF dhe jemi të pajtimit pasi është në interes të qytetarëve.

Florije Boshnjaku – Edhe ne si grupe i AAK-së jemi të pajtimit që të shfuqizohet vendimi dhe të miratohet vendimi tjetër, por mendoj se të dyja pikat duhet të votohen veç e veç pra dy herë të votohet për secilën pikë.

Kryesuesi – Të nderuar pasi diskutuam për të dyja pikat atëherë së pari pe qesim në votim Propozimin e Vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit 01 Nr. 585, rreth ndërtimit të palestrës sportive në Krushë të Madhe, pastaj e qesim në votim pikën e 10 Propozimin e Kryetarit 01 Nr. 124/2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronës së Paluajtshme komunale për “Ndërtimin e Palestrës Sportive”, në fshatin Krushë e Madhe.

E qes në votim Propozimin e Vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizim të vendimit 01 Nr. 585, rreth ndërtimit të palestrës sportive në Krushë të Madhe: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar shfuqizimi i vendimit të pikës 9 (nëntë).

E qes në Votim Propozimin e Kryetarit 01 Nr. 124/2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronës së Paluajtshme komunale për “Ndërtimin e Palestrës Sportive”, në fshatin Krushë e Madhe: Konstatohet se me shumicë votash është aprovuar pika e 10 (Dhjetë). Kalojmë në pikën e radhës:

Pasi nuk e kemi prezent për momentin përkthyesin kalojmë një herë në pikën e 12 pastaj kthemi tek pika e 11, nëse jeni të pajtimit edhe ju të nderuar Kuvendar.

12. Shqyrtimi i Propozimit të Kryetarit dhe marrja e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare.

Kryetari – Ju para vete e keni një propozim i cili është marrë si rezultat i një situata që ka i ka ndodhur një kryefamiljari i cili ka një histori mjaftë të dhimbshme ai i ka të vdekur 3 fëmijë ku ka mbetur vetëm me një djalë, nuk e dimë se cili ka qen faktori që ju është djegur stalla me të cilën ke nxjerrë kafshatën e bukës, por e di që në momentin kur ka ndodhur unë kam shkuar personalisht, fakti që ju kanë djegur 3 lopë dhe ju është djegur tërësisht stalla dhe ushqimi i begative. Ne si Komunë e kemi formuar një komision i cili e ka vlerësuar dëmin dhe sipas komisionit dëmi që ju është shkaktuar z. Hajredin Mustafës është mbi 10,000.00 €, dëshira jonë ka qen që ti ndihmojmë më shumë se që kam propozuar por mundësitë financiare janë këto që janë dhe ne mendojmë se nëpërmjet kësaj ndihme ne do të mundë ti ndihmojmë diçka që së paku të vazhdojë këtë traditë. Ju ftoj që ta apromoni propozim vendim me shpresë se nëse dele ndonjë partner tjetër të ja ndërtojmë edhe stallën në mënyrë që të kompletojmë.

Rasim Fazliu – Fillimisht shpreh keqardhje kësaj familje që i ka ndodhur ky rast uroj që ky rast të mos përsëritet, që në fillim po ju them që jam për atë që të ju dilet në ndihmë familjeve kur ju ndodhin rastet e tilla, po ashtu edhe për këtë rast jam që ti dilet në ndihmë këtij personi në fjalë. Por unë e kam një shqetësim tjetër shpresojmë që mos ndodhë por besoj se Komuna nuk do të ishte mirë që të bëjë përjashtime nëse i do ti ketë kësi lloje kërkesash, pra dikujt të i ndihmohet e dikujt jo, a do të jemi ne në gjendje gjithmonë që ti ndihmojmë të

gjithëve po e përsëris shpresoj dhe lutem që mos të ketë raste të tjera, përndryshe jam pro këtij propozim vendimi.

Florije Boshnjaku – Së pari Kryetar ju falënderoj që keni marrë një iniciativë të këtillë, këtë familje e njohë mirë sepse kam pas rast që ta vizitoj kur kam qenë Drejtoresh në QPS, njëkohësisht e falënderoj edhe Drejtorin e Bujqësisë i cili na ka kompletuar lëndën dhe ne si Kuvendarë kemi fakte dhe argumente për me e përkrah këtë rast që e tha edhe kolegu më herët shpresojmë se nuk do të kemi më kesi raste sepse është mirë që ti përkrahim të gjitha rastet të cilat kanë nevojë, prandaj mendoj se ky propozim duhet që të përkrahët dhe të aprovohet.

Ali Zhuniqi – Padyshim se edhe unë e mbështesë iniciativa të tilla kur ka fatkeqësi, ajo që është shqetësuese këtu është se procesverbali i vlerësimit të dëmeve është i gjithë i paqartë pra nuk është duke u parë fare ose shumë dobët dhe nuk ke mundësi ta lexosh, prandaj kisha kërkuar kur të shkruhet procesverbali nga inspektorati së paku të jetë më i qartë tamam ashtu si duhet, pavarësisht kësaj ne jemi pro mbështetjes së iniciativave të këtilla dhe pa dyshim se do ta mbështesim.

Hanalora Hoti – Flas në emër të grupit të LDK-së ne jemi pro këtij propozim vendimi dhe ndjejmë shumë keqardhje për këtë rast.

Kryetari – I nderuari Kuvendar Ali Zhuniqi është vërejtje me vend atë që e ngritët si problem, por inspektorati procesverbalet i shkruajnë me laps dhe gjatë fotokopjimit është dobësuar dhe nuk shihet mirë është e vërtet, por nëse ka nevojë dikush do ju sjellim edhe origjinalin. Po ashtu e kuptoj z. Rasim Fazliun por do zoti asnjëherë më nuk ndodhin këso raste por ajo që na ka shtyrë që ti ndihmojmë është edhe historia tragjike e kësaj familje dhe ne është dashur që të tregojmë që së paku Komuna jonë duhet të bëjë diçka.

Kryesuesi – E qes në votim Propozimin e Kryetarit për marrjen e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 12 (dymbëdhjetë). Kalojmë në pikën e radhës:

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për iniciimin e procedurave për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

Ju sot duhet vetëm të jepni një aprovim për iniciim të procedurës për zgjedhjen e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, Kuvendi Komunal zgjedh një Komision had – hoc nga pesë anëtarë, 2 anëtarë zgjedhën nga Komuniteti serbë, 1 nga kisha ortodokse kurse 2 anëtarë zgjedhën nga Kuvendi. Po ashtu duhet që të bëhet ftesë publike ku do të njoftohen qytetarët e Komunës sonë.

Isak Hoti, shef i zyrës ligjore – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, realisht ky venim të nderuar Kuvendarë është që ti japim dritën e gjelbër Kryetarit të Komunës që të inicioj procedurat për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, komisioni had – hoc që e përmendi Kryesuesi realisht bëhet pas ftesës publike e cila duhet të qëndrojë 15 ditë, pastaj Kuvendi i Komunës brenda 7 dite pas kalimit të afatit për aplikim të kandidatëve nxjerrë vendim për caktimin e anëtarëve të Komisionit had – hoc i cili duhet që të përbëhet prej 5 anëtarëve, 3 anëtarë zgjidhen nga fshati kurse 2 nga kuvendi Komunale. Pra komisionin mundemi ta formojmë në mbledhjen tjetër sepse kështu e specifikon udhëzimi administrativ Nr. 011/2014 Për themelimin, zgjedhjen, përzgjedhjen dhe funksionimin e Këshillit për Fshatin Hoçë e Madhe, po ashtu edhe ligji e përcakton shumë qartë, pra të gjitha procedurat nxirën pas ftesës publike.

Mirjeta Krasniqi – Tek pika e parë Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e vetë të mbajtur me 20.03.2018 mos është bërë ndonjë gabim teknik sepse ne nuk kemi mbajtur në këtë datë kurrfarë mbledhje.

Isak Hoti – Zyrtari kur e ka hartuar këtë vendim sigurisht është hutuar dhe e ka cekur propozimi kur ka shkuar tek Kryetari i Komunës, po është gabim teknik ajo do të përmirësohet.

Trajko Shariq – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, kam një pyetje teknike cila është mënyra e përzgjedhjes të atyre dy anëtarëve të fshatit Hoçë e Madhe. E kam kuptuar që komisioni do të formohet pasi të kalojë afati i ftesës por pyetje është si mund të dimë ne që ata dy anëtar e kanë përkrahjen e banorëve të fshatit Hoçë e Madhe, pra cila është procedura e përzgjedhjes së dy anëtarëve brenda këshillit të fshatit.

Isak Hoti – Në bazë të shqyrtimit të aplikacioneve që kanë qenë përmes konkursit sepse ne kemi hapur konkurs për këtë, kriteret dhe procedurat janë të përcaktuara në udhëzimin administrativ po ashtu edhe në ligjin me

Nr. 04 L/062. Pra komisioni ka për detyrë të i zgjedhë këta dy kandidat që aplikojnë në bazë të kushteve dhe kriterëve që do të përcaktohen për mes konkursit.

Trajko Shariq – A duhet që të ndiqet procedura e njëjtë sikurse për përzgjedhjen e anëtarëve për themelimin e Komitetit për Komunitete, ku duhet që të mbliidhen nënshkrimet apo duhet të ndiqet procedura tjetër.

Isak Hoti – Ky është një ligj i veçantë dhe në kuadër të këtij ligji është një udhëzim tjetër, kurse kur kemi fole për Komunitetin për Komunitete ka qen një ligj tjetër dhe një udhëzim krejt tjetër, kjo i përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat për zgjedhjen e kandidatëve për Këshillin e Hoçës së Madhe. Në nenin 8 ceket kështu pika 1: Dy kandidatët nga qytetarët e Komunës së Rahovecit do të zgjidhen nga Kuvendi në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenin 6 të këtij udhëzimi administrativ, pra flitet për dy qytetar jo të komunitetit serb, kurse dy kandidat duhet të jenë banorë të fshatit Hoçë e Madhe të cilët zgjidhen drejtpërsëdrejti nga fshati Hoçë e Madhe dhe një kandidat zgjidhet nga Kisha Ortodokse, kjo është procedura e përbërjes së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.


Kryesuesi - E qes në votim Propozim Vendimin për iniciimin e procedurave për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe: Konstatohet se me 1 abstenim, asnjë kundër dhe të tjerët pro është aprovuar pika e 11 (njëmbëdhjetë) e rendit të ditës.

Florije Boshnjaku – I nderuari Kryesues sa e di ju është kthyer vendimi që kemi marrë për pagesën e mëditjeve të gjitha anëtarëve të Komisionit që formohen nga Kuvendi i Komunës nga MAPL-ja ku është kërkuar që të specifikohen se kush duhet që të paguhet.

Isak Hoti – Po është e vërtetë është kthyer edhe vendimi për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të Komisionit që formohen nga Kuvendi i Komunës, këtu nuk bëhet fjalë për shërbyes civilë sepse ata nuk paguhen, kurse stafi politik nga Kuvendi duhet të paguhet. Por MF na ka kthyer për vet faktin se ka kërkuar që të specifikohet se sa komisione do të bëhen brenda mandatit 4 vjeçar, këtë ne nuk po jemi në gjendje me e ditë, pastaj sa është mëditja e tyre, pse duhet që të paguhet për punën e tyre, mendoj se edhe ata nuk kanë ditë se çka kanë kthyer dhe çka janë duke kërkuar, sepse një vite më herët i njëjti vendim është miratuar dhe ka funksionuar çdo gjë si është më së mirë. Mendoj se Ministrisë së Financave ne ja kemi për obligim me ja kthye një përgjigje.

Kryesuesi – Ju falënderoj për pjesëmarrje shihemi në mbledhjet e radhës.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 14:00

Procesmbajtësi

 Skender Hamza

